REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**
**DREJTORIA E TRAJNIMIT DHE LICENSIMIT**

Nr.2495/13 prot.

Tiranë, më 26.12.2023

**VENDIM**

**Nr. 126, datë 26.12.2023**

**PËR**

**MIRATIMIN E DHËNIES SË PËRJASHTIMIT**

Në bazë të VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe Urdhrit të Ministrit Nr. 91, datë 21.2.2019 "Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e kërkesave teknike edhe procedurave administrative në lidhje me licencat dhe çertifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror",

Në vijim të kërkesës së Ofruesit të Shërbimit të Navigimit Ajror "Albcontrol" SH.A.,

Në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 53/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil",

Autoriteti i Aviacionit Civil analizoi rrethanat (*sipas ACAA-DLS-EXMP-101 dhe ACAA-DLS-EXMP-102*) dhe vlerësoi se:

Nisur nga sa më sipër,

**VENDOSA**

1. Dhënien e përjashtimit "Për afatin e kryerjes së kursit të trajnimit rifreskues për KTA" nga parashikimet e pikës 13, "Trajnimi i vazhdueshmërisë" i Skemës së Kompetencës së Albcontrol, Edicioni 4.1, miratuar me shkresën e AAC nr. 1421/2, datë 26.08.2022.
2. Ky përjashtim zbatohet për Kontrollorët e Trafikut Ajror që operojnë në "Albcontrol" SH.A.
3. Ky përjashtim është në fuqi deri në datë 30.04.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Maksim Et'hemaj**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË - AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL - TIRANË

Rr: "Sulejman Delvina", Nr.1, P.O Box 205, Tiranë, Tel: +355 42251220, E-mail: sekretaria@acaa.gov.al